



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

FJALIMI I KRYETARIT TË GJYKATËS KUSHTETUESE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, PROF. DR. ENVER HASANI, NË CEREMONINË E V-të SOLEMNE TË VITIT GJYQËSOR TË GJYKATËS KUSHTETUESE

Zonja dhe zotërinj,
Të nderuar pjesëmarrës,

Më lejoni që, në fillim të kësaj ceremonie të V-të të shënimit të Vitit Gjyqësor të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, t'ju falënderoj nga zemra, në emrin tim dhe në emër të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, për kohën që keni gjetur, nga koha juaj e çmueshme, për të qenë pjesëmarrës në këtë ceremoni solemne të Gjykatës sonë.

Nga ceremonia në ceremoni po na shtohen miqtë nga rajoni, nga Evropa e nga mbarë bota dhe për këtë jemi shumë të lumtur.

Ju falënderoj të gjithëve!

Zonja dhe zotërinj,

Pak histori: Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës u themelua në fillim të vitit 2009 dhe nisi funksionimin e saj të plotë në vjeshtë të vitit 2009. Dhe, nuk do t'i përmend vështirësitë e fillimit, sepse ato mund t'i paramendojë secili prej jush.

U bënë pesë vjet jetë e punë të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës. Pesë vjet të mëdha për gjyqësinë kushtetuese të shtetit të Kosovës. Pesë vjet të mëdha edhe për ne që dhamë gjithçka nga vetvetja për ta ngritur në këmbë të forta e të shëndosha Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, këtë autoritet përfundimtar të rendit kushtetues të vendit, këtë autoritet që ndihmoi e që po ndihmon në ndërtimin e shoqërisë demokratike kosovare që bazohet në sundimin e ligjit, në respektimin e të drejtave të njeriut dhe të minoriteteve dhe në garantimin e ndarjes së plotë të pushteteve.

Në këto pesë vjet, Gjykata jonë pati për udhërrëfyes standardet kushtetuese të gjykatave simotra evropiane dhe sidomos standardet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Kështu do të jetë edhe në të ardhmen. Dhe, falë kësaj, vendimet e Gjykatës sonë kanë dhënë një kontribut të çmueshëm në respektimin e parimeve, të garancive, si dhe në mbrojtjen e vlerave kushtetuese në shoqërinë kosovare...

Kemi realizuar me shumë sukses Planin Strategjik 2010-2013 dhe kemi nisur realizimin e Planit Strategjik 2014-2017. Në Planin e kaluar u ballafaquam me sfida nga më të ndryshmet, por ato i përballuam me sukses. Sfidat eventuale do t'i përballojmë me sukses edhe në të ardhmen.

Që nga themelimi e deri më sot, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës ka pranuar gjithsej 892 kërkesa individuale e kolektive drejtuar asaj. Prej tyre, janë zgjidhur 839 kërkesa. Të tjerat janë në procedurë e sipër. Ishim dhe do të jemi shumë efikas.

Të nderuar pjesëmarrës,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, falë punës së saj të mirë e të drejtë, gëzon respekt e autoritet në Republikën e Kosovës. Gëzon respekt dhe autoritet edhe në rajon, në Evropë e në botë.

Këtë e dëshmon edhe anëtarësimi i saj me të drejta të plota në Konferencën Botërore të Drejtësisë Kushtetuese, para një muaji, dhe ky anëtarësim i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës në Konferencën Botërore të Drejtësisë Kushtetuese u bë i mundur pas aktivizimit të anëtarësimit të Republikës së Kosovës në Komisionin e Venecias të Këshillit të Evropës.

Ky fakt e obligon Gjykatën tonë për përkushtim edhe më të madh për të mbajtur hapin me institucionet moderne të gjyqësisë kushtetuese, jo vetëm në rajon por edhe në Evropë e në botë.

Deri më sot, kemi punuar në mënyrë aktive, së bashku me gjykatat kushtetuese të vendeve të tjera, në shkëmbimin e përvojave me qëllim të zhvillimit të thellësisë dhe të gamës së mirëkuptimit të teorisë dhe të praktikës së të drejtës kushtetuese. Nëpërmjet këtyre përvojave, Gjykata jonë ka qenë në gjendje të zhvillojë kapacitetet e saj dhe të krijojë reputacionin e saj në raport me komunitetin ligjor ndërkombëtar. Përfitimi nga prania e gjyqtarëve ndërkombëtarë dhe e këshilltarëve ligjorë ndërkombëtarë në Gjykatë forcohet më tej nëpërmjet këtyre projekteve të bashkëpunimit ndërkombëtar.

Më lejoni të përmend edhe faktin se, falë Ambasadës së Konfederatës së Zvicrës në Kosovë, si donator kryesor, por edhe falë ndërmjetësimit të Zyrës së Këshillit të Evropës në Prishtinë, sivjet filloi projekti me të cilin është bërë i mundur trajnimi i këshilltarëve ligjorë të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, me seli në Strasburg.

Trajnimi i këshilltarëve ligjorë të Gjykatës sonë në Gjykatën e Strasburgut (nga dy këshilltarë qëndrojnë me rotacion nga 5 muaj në Strasburg), ka për qëllim përvetësimin sa më të mirë të praktikave të gjyqësisë evropiane dhe zbatimin e tyre në gjyqësinë kushtetuese të Kosovës.

Zonja e zotërinj,

Këto që kemi arritur për pesë vjetët që po lëmë pas do të ishin të pamundshme pa angazhimin e madh të gjyqtarëve dhe gjithë stafit tjetër të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, pa mbështetjen materiale nga Buxheti i konsoliduar i Kosovës, por do të ishin të pamundshme edhe pa ndihmën dhe pa asistencën e pakursyer të donatorëve ndërkombëtarë: Komisionit Evropian, Këshillit të Evropës, qeverive të vendeve mike: Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Mbretërisë së Bashkuar, Zvicrës, Norvegjisë, Finlandës, Holandës, pastaj Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX), Zyrës Civile Ndërkombëtare (ZCN), Projektit të Reformës Ligjore (GIZ), Fondacionit Gjerman për Bashkëpunim Ligjor Ndërkombëtar (IRZ), Departamentit të Mbretërisë së Bashkuar për Zhvillim Ndërkombëtar (DFID), Institutit të Menaxhimit të Njesisë Lindje-Perëndim (EWMI), Programit të Shtetit Ligjor Efektiv në Kosovë (EROL), Agjencisë Turke të Bashkëpunimit dhe Koordinimit (TIKA) dhe Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Turqisë.

Në emër të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i falënderoj nga zemra për përkrahjen e dhënë.

Të nderuar pjesëmarrës,

Ne, në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, jemi të betuar se do të vazhdojmë me ngulm kryerjen e misionit tonë të shenjtë në sigurimin e funksionalitetit të institucioneve të Republikës së Kosovës në përputhje me Kushtetutën dhe në sigurimin e mbrojtjes së të drejtave dhe të lirive individuale të garantuara me Kushtetutë.

Ishim dhe do të jemi plotësisht të pavarur dhe rruga jonë e vetme ishte dhe do të mbetet parimi i paanshmërisë në marrjen e vendimeve tona.

Ju falënderoj për vëmendje!

Prof. dr. Enver Hasani, kryetar

Prishtinë, më 15 tetor 2014